

Hyrjet dhe daljet e TVSH-së

Dokument për njohjen e zbatimit të TVSH

Studime dhe mendime mbi legjislacionin fiskal në Shqipëri, 11-01

Qendra AL-TAX

Dokumente Fiskale

www.al-tax.org

altax@constulant.com

10/31/2011

Tiranë, Shqipëri



Hyrjet dhe daljet e TVSH-së

Hyrje

Ky punim është një orientim në lidhje me TVSH-në, si atë të zbritshme dhe të shtuar gjate zhvillimit të aktivitetit tuaj ekonomik. Shumë praktika të përditshme, shpesh duhet të bazohen mbi parimet bazë, të cilat ndihmojnë në trajtimin e rasteve më të komplikuar të zbatimit të ligjit të TVSH.

AL-TAX ka ndërmarrë këtë nismë, për të ndihmuar sipas këndvështrimit të Qendrës, në referencë të ligjit në zbatimin e rasteve që përfshihet zbatimi në jetën e përditshme i parimeve të ligjit.

Materiali që është përgatitur nga punonjësit e Qendrës AL-TAX do të pasohet nga dokumente të tjera, në serinë e përmbledhjeve me tema për TVSH-në, me synimin që të kthehet në një forum diskutimi për gjithë ata që interesohen, ose kanë lidhje të pandashme të zbatimit të praktikave të tyre.

Autorësia është i AL-TAX, dhe nga cdonjëri që do të përdorë këtë material, kërkohet të shënojë autorësinë si referencë në materialet që do të përdorë.

Dokumenti gjendet te faqja në internet www.al-tax.org

Nëse keni kërkesa dhe pyetje dërgojini te altax@consultant.com

Tiranë, Tetor 2011

Hyrjet dhe daljet e TVSH-së

1. Çfarë është TVSH e shitjeve?

Kjo është një tatim i asaj vlere që shtoni kur u shisni një mall apo shërbim klienteve tuaj, pasi ju konsideroheni se keni kryer një furnizim të tatueshem.

1.1 Çfarë janë furnizimet e tatueshme?

Nese ju jeni biznesmen dhe shisni të mira (mallra ose shërbime), ose ju beni dicka për një person tjetër dhe paguheni për ate që beni është gjithnje një furnizim i tatueshem. Që të quhet një furnizim që ju beni i tatueshem duhet që :

- të jeni i regjistruar në TVSH
- të kryeni një furnizim malli ose një shërbim
- të kryhet brenda territorit shqiptar
- të paguheni për këtë furnizim që kryeni
- të jete pjese e aktivitetit që keni deklaruar.

1.2 Ka lloje të tjera furnizmesh?

Po. Një numer i caktuar biznesesh, që ligji i TVSH-se thote të mos ngarkojne shitjet e tyre me TVSH. Të tilla janë furnizime të caktuara shërbimesh si :

- shërbimet financiare si : dheniet e huave, transaksionet për pronat, llogarite bankare, transaksionet lidhur me monedhën, bankënotën dhe paranë, përveç artikujve te përdorur vetëm për koleksione, transaksionet lidhur me aksionet, kapitalet financiare, obligacionet dhe letra të tjera me vlerë, përveç shërbimeve për mbikqyrje, administrimin e fondeve të investimeve, transaksionet në lidhje me kontratat për sigurimin e jetës, duke përfshirë risigurimin, transaksionet në lidhje me administrimin e fondeve të pensioneve dhe sigurimet e detyrueshme shëndetësore;
- furnizimet e arit, bankënotave a monedhave për Bankën e Shqipërisë;
- furnizimi i pullave te postës për përdorim për shërbime postare ose pulla të ngjashme;
- furnizimi i bërë nga një organizatë jofitimprurëse nga organizata fetare a filozofike me qëllim mirëqënien shpirtërore;
- furnizimet për misionet diplomatike e konsullore, si dhe personelin e tyre mbi bazën e reciprocitetit dhe përjashtimin

Hyrjet dhe daljet e TVSH-së

Dokument për njohje e zbatim të TVSH nga AL-TAX

- e furnizimeve për organizata ndërkombëtare, mbi bazën e marrëveshjeve ndërkombëtare.
- furnizimi i shërbimeve që kryhen nga kontraktorët e nënkontraktorët e tyre, të vërtetuar si të tillë nga Agjencia Kombëtare e Hidrokarbureve, lidhur me realizimin e fazave të kërkimit dhe të zhvillimit të operacioneve hidrokarbure;
- furnizimi i pajisjeve mjeksore dhe i ambalazheve e materialeve që përdoren për prodhimin dhe konfeksionimin e barnave, janë furnizime të përjashtuara;
- shitja e gazetave, revistave e shërbimet e reklamave në to;
- furnizimi falas, si ndihme për situatat e përcaktuara, sipas ligjit nr.8756 datë 26.03.2001 "Për emergjencat civile".

Keto lloj furnizimesh quhen të perjashtuara. Është e rëndësishme të dini kur beni një furnizim të perjashtuar, apsi kjo ka të bëjë me ngarkesën e TVSH-se që ju duhet të merrni për gjera që bleni për biznesin tuaj.

1.3 A është e njëjtë gjithnjë përqindja e TVSH-së?

Jo. Të paktën në vitin 2011, janë në aplikim tre shkalle të përqindjeve të TVSH-se:

- shkalla standarte, aktualisht 20 %
- shkalla e reduktuar, 10% (për medikamentet);
- shkalla e ulët, 0 %

Perqindjet e TVSH-se (shkallet e tatimit) ndryshojnë në varesi të politikave fiskale të qeverive.

1.4 Si ta di që një furnizim është i trajtuar me 0 % TVSH?

Kjo merret vesh nëse i referohemi ligjit të TVSH-se, i cili jep dhe rastet perkatese ku shkalla e TVSH-se është 0 %. Të tilla janë:

- importimi i mallrave të vendosura në regjimin tranzit;
- importimi i mallrave të deklaruara për të qënë nën regjimin e lejit të përkohshëm dhe atë të përpunimit aktiv;
- importimi i mallrave dhe shërbimeve që lidhen me realizimin e fazave të kërkimit dhe të zhvillimit të operacioneve hidrokarbure, të kryera nga kontraktorët ose nënkontraktorët që punojnë për këto operacione. Kontraktorët dhe nënkontraktorët vërtetohen si të tillë nga Agjencia Kombëtare e Hidrokarbureve;
- mallrat që eksportohen nga territori i Republikës së Shqipërisë;

Hyrjet dhe daljet e TVSH-së

Dokument për njohje e zbatim të TVSH nga AL-TAX

- furnizimet e mallrave e të shërbimeve në lidhje me transportin ndërkombëtar të mallrave ose të pasagjerëve;
- furnizimet e mallrave a shërbimeve në lidhje me veprimtaritë tregtare ose industriale në det

1.5 Cili është ndryshimi midis furnizimeve të përjashtuara dhe atyre me 0 % TVSH?

Furnizimet e përjashtuara si ne shitje, por edhe ne blerje janë pjesë e një grupi nenesh, që përcaktohen të ligji i TVSH. Megjithatë, në zbatimin e ligjit në praktiken e përditshme, në rastin e një eksportuesi, ai ka të drejtën e kreditimit të TVSH-se se blerjeve duke kërkuar rimbursim të tyre. Në rastin e një aktiviteti të përjashtuar cdo blerje e tij nuk mund të kreditohet me TVSH për furnizimet që kryen. Nëse jeni në rastin e furnizimeve të përjashtuara, ju nuk do të mund të merrni TVSH, pasi nuk jeni pjesë e skemes së përfitimit.

1.6 A ka për tu thënë ndonjë gjë tjetër?

Po. Disa gjera nuk janë pjesë e sistemit të TVSH-se. Këto gjera janë ato që mund t'i quajmë jo të përditshme.

Kështu, të tilla janë :

- **Vetefurnizimet.** Nëse një person i tatueshëm do të përdori për qëllime të veprimtarisë së tij ekonomike të tatueshme, mallra të cilat i prodhon vetë , trajtohet edhe sikur i furnizon (shet) këto mallra si pjesë të kësaj veprimtarie të

tatueshme, edhe sikur furnizohet (blen) me këto mallra për qëllimet e ushtrimit të veprimtarisë së tij ekonomike të tatueshme. *Kushti i vetëfurnizimit është:* mallrat e prodhuara nga tatimpaguesi të përdoren po nga ai për qëllime të furnizimeve të tatueshme për t'u bërë (të ketë të drejtën e kreditimit). Në këtë rast personi i tatueshëm lëshon një faturë tatimore shitje për veten, që do të thotë që është dhe shitësi dhe blerësi. Vlera e tatueshme e furnizimit për vetë është kostoja e prodhimit.

- **Transferimi i veprimtarisë ekonomike.** Nëse një person i tatueshëm shet komplet veprimtarinë ose një pjesë të saj një personi, i cili është ose bëhet i tatueshëm në lidhje me veprimtarinë e blerë, duke e vazhduar atë, dhe ky transaksion plotëson 2 kushte njëkohësisht që janë:

- 1) *Kushti ekonomik*
- 2) *Kushti ligjor*

atehere, furnizimi nuk është i tatueshëm dhe quhet transferim i veprimtarisë ekonomike.

Hyrjet dhe daljet e TVSH-së

Dokument për njohje e zbatim të TVSH
nga AL-TAX

1) *Plotësim i kushtit ekonomik kërkon që:*

veprimtaria e cila transferohet të ketë autonomi ekonomike, pra të ketë mundësinë të funksionojë si e pavarur tek marrësi. Autonomia ekonomike presupozon ekzistencën e të gjitha kushteve për realizimin e prodhimit, si ambientin, lëndët e para, makineritë...etj.

Shitja vetëm e njëres prej tyre (lëndës së parë, makinerive ose ambienteve...etj) nuk ka të bëjë me transferimin e veprimtarisë ekonomike, por vetëm me një furnizim të zakonshëm mallrash, për të cilin aplikohet TVSH.

2) *Plotësim i kushtit ligjor kërkon që:*

a) të bëhet në të gjitha rastet verifikimi i bilancit të shitësit. Të shihet sa dhe cilat asete të aktivitetit përdoren për prodhimin e produktit dhe sa janë transferuar, po kështu në pasiv sa të ardhura janë realizuar për shkak të kësaj shitje. Të njëjtat verifikime do të bëhen në bilancin e blerësit (në të cilin është transferuar veprimtaria), sa asete kanë hyrë dhe çfarë veprimesh janë bërë në pasiv.

b) të jetë noterizuar i gjithë veprimi i bërë.

- **Shitja e aktiveve.** Në se personi i tatueshëm jep mallra, të cilat janë pjesë të aseteve të veprimtarisë së tij ekonomike ,p.sh.: i shet, i fal ose i përdor privatisht ,ky është një furnizim i tatueshëm dhe mbi vlerën e tatueshme të këtyre furnizimeve llogaritet TVSH.

- **Përdorimi privat i mallrave.** Kur mallrat ,të cilat i përkasin veprimtarisë ekonomike të një

personi të tatueshëm përdoren privatisht jashtë kësaj veprimtarie, furnizimi është i tatueshëm, ku keto mallra janë prodhuar vetë, si dhe mallrat nga inventari ose nga aktivet e veprimtarisë ekonomike të personit të tatueshëm. Përdorimi privat përfshin edhe përdorimin personal nga personi i tatueshëm të aktiveve të veprimtarisë së tij ekonomike. Ai gjithashtu përfshin edhe përdorimin nga persona të tjerë të tillë si një i punësuar, i afërt, një mik etj. Vlera e tatueshme me e ulët (minimale) duhet kontrolluar gjithnjë, nese midis perfituesit nga shërbimi dhe atij qe kryen shërbimin ekzistojne lidhje te ngushta.

Konsiderohet si përdorim privat në çastin e çregjistrimit, inventari gjendje i aseteve, për të cilat është paguar TVSH në blerje. Në këtë çast, personi i tatueshëm është i detyruar të paraqesë një Formular Deklarimi dhe *Pagesë përfundimtare*, që përmban informacionet që kërkohen nga organi tatimor. Kjo deklaratë do të ketë të llogaritur TVSH mbi gjendjen e mallrave(stoqet) në datën e çregjistrimit të vlerësuar sipas vlerës së tregut dhe mallrat kapitale (pajisjet) gjendje të vlerësuar duke përdorur koeficientin e amortizimit vjetor që merret 1/5.

- **Furnizime kundrejt pagesës së reduktuar.** Raste të tilla janë kur, furnizuesi nuk arkëton pagesën p.sh. dhuratat, mallra e shërbime të furnizuara si nxitës (ofrohet një dhuratë me kusht që blerësi të blejë dicka ose të bëjë

Hyrjet dhe daljet e TVSH-së

Dokument për njohje e zbatim të TVSH nga AL-TAX

veprime të tjera në dobi të shitësit]] ose pagesa është dukshëm më e vogël se ç`duhej të ishte nëse qëllimi i furnizuesit ka qënë fitimi për këtë dhe furnizime të ngjashme. Mallrat dhe shërbimet e furnizuara në rrethanat e mësipërme janë të tatueshme dhe vlera e tatueshme e tyre është vlera totale që duhet të ishte e pagueshme në lidhje me atë furnizim, nëse qëllimi i furnizuesit është nxjerrja e fitimit.

- **Furnizimi i tokës dhe truallit dhe dhënia me qera e tyre.** Në keto raste kemi furnizime të përjashtuara. Kur toka përdoret për parkimin e mjeteve të transportit dhe mjeteve të tjera lëvizëse shërbimi është i tatueshëm me TVSH.

- **Dhënia me qera e ndërtesave.** Ky furnizim shërbimi si dhe furnizimi i shërbimeve të ndërtimit dhe të mirëmbajtjes është një furnizim i tatueshëm.

2. Çfare është këmbimi i shërbimeve?

- **Kundersherbimi.** Nje kembim shërbimesh kemi atehere kur shërbimi kryhet per arsye te nje kundërshebimi dhe keshtu vlera e tyre percaktohet sipas vleres mesatare që ka në tregun e ngjashem. Kembimi i shërbimeve nenkupton ekzistencen nga njera ane e nje sipermarresi qe sherben dhe te nje perfituesi shërbimi nga ana tjetër. Perfituesi i shërbimit duhet te jete nje person *tjetër* (person fizik ose juridik ose nje

shoqeri). Shembuj të tille për kembim shërbimesh mund të jenë:

Bakshishet: Pjese e kundërshebimeve , kur ato i jepen ndermarresit. Nuk jane te tatueshme kur i jepen kamerierit.

Zevendesim kostoje: Çon ne kembim shërbimi (fitimi nuk eshte domosdoshem)

Shërbime per koston e veta: Çon ne kembim shërbimi (si zevendesimi i koston)

Pagese e vullnetshme: Pjese e kundërshebimit

- **Pagesa te procedurat e kembimit. Si gjendet vlera e tatueshme kur pagesa per nje shërbim nuk perbehet nga para, por nga shërbime?**

Te procedurat e kembimit nje vleresim i shërbimit eshte i nevojshem. Vendimtare per ndermaresin qe kryen shërbimin eshte Vlera (cmimi i zakonshem i shitjes) se kundërshebimit. Nuk behet fjale per vleren e vete shërbimit. Diferencat e vlerave ekuilibrohen mes partnerve normalisht permes pagesave shtese. Ne rastet e mashtrimit eshte per tu kotrolluar baza me e ulet matese. Neqoftese eshte e njohur vetem vlera e shërbimit te vete personit apo mungon nje e dhene mbi vleren e pergjithshme te kundërshebimit , ne kete rast duhet nisur nga barasvlefshmeria. *Vlera* e kundërshebimit (pageses) (cmimi i zakonshem ne vend) eshte nje *vlerë bruto*. Per kerkimin e vleres se tatueshme duhet llogaritur TVSH.

Hyrjet dhe daljet e TVSH-së

Dokument për njohje e zbatim të TVSH
nga AL-TAX

2.1 Çfarë është qarkullimi i brendshëm?

Midis dy ndermarjeve të një personi të tatueshem nuk mund të ketë kimbim të tatueshem shërbimesh sepse *nje* sipërmarrës mund të ketë vetëm *shume* aktivitete por vetëm një shoqëri me një numër identifikimi, me adresë të ndryshme (nuk janë persona juridike të vecante). Tek shërbimet brenda një ndermarjeje flitet për një *qarkullim të brendshëm*. Qarkullimi i brendshëm nuk është i tatueshem dhe për këtë arsye nuk kemi të bëjmë as me TVSH për tu paguar as me një zbritje TVSH-je. Filialet e një personi të regjistruar janë të shpërndara në qytete të ndryshme. Në një rast të tillë, çdo filial duhet konsideruar si adresë e vecante, por me të njëjtin numër identifikimi. Ky lloj rregullimi egziston për arsye menaxhimi nga administrata. *Neqoftese për shëmbull qendra ndodhet në Tiranë dhe filiali në Durrës, atëherë filiali i Durrësit duhet të kontrollohet që nga Tirana, dhe menaxhimi i TVSH-së së tij është objekt i Drejtorisë së Tatimeve Tiranë, ku ka qendrën filiali. Qarkullimi i mallrave nga një filial në*

tjetrin bëhet nepermjet dokumentimit me faturë shoqëruese, që nuk ka TVSH.

1.9 Çfarë duhet të mendoj për gjithë këto që po lexoj?

Kur nuk jeni pjesë e sistemit të TVSH-së (paguani takson vendore të biznesit të vogël, apo tatim mbi të ardhurat tuaja personale, takson doganorë apo dhe akcizen për mallra personale në doganë, mbitaksa etj.) ju nuk shikoni rëndësinë e zbatimit të TVSH-së në çdo hap të qarkullimit të mallrave apo shërbimeve. Por, e rëndësishme është që zinxhiri i qarkullimit të jetë i regjistruar në radhë të parë në kuponat, faturat, apo fletë porosi që ju merrni si kliente të atij malli apo shërbimi që e keni paguar. Mos harroni, se çmimin që ju paguani duhet ta derdhe në shtet ai që jua shet. Që shitesi ta regjistrojë duhet t'ju japë faturën. Ju vertet nuk paguani TVSH dhe nuk ka çfarë tu duhet një faturë me TVSH në jetën tuaj të përditshme, por ajo vlen për të dhënë secili kontributin e tij për përmirësimin e jetës së gjithëve nepermjet rritjes së të ardhurave nga TVSH në kimbim të shërbimeve dhe veprave publike.